

8 nëntor 2025,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.11.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.10/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga lojtari Muhamedali Janjeva për marrjen e statusit si lojtar i lirë (“free agent”) ¹ jashtë afatit kalimtar.
- II. Duke u bazuar në nenet përkatëse të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së, dhe pasi janë plotësuar kushtet e nevojshme ligjore dhe sportive, Komisioni i Garave VENDOS: **MIRATOHET** kërkesa e lojtarit Muhamedali Janjeva për marrjen e statusit “Lojtar i Lirë” (“Free Agent”) jashtë afatit kalimtar. Lojtari nga kjo datë ka të drejtë të negociojë dhe të nënshkruajë kontratë me cilindo klub brenda FBK-së apo në kampionate të jashtme, pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.
- III. Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ Lojtar i lirë (free agent) – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

ARSYETIM


Gjatë vendimarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.10/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Komisioni i Garave pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe në bazë të **Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së** për sezonin **2025/2026**, konstaton sa vijon:
- (b) Lojtari **Muhamedali Janjeva** deri më tani ka qenë pjesë e **KB Sigal Prishtina**.
- (c) Lojtari është paraqitur për klubin në fazën përgatitore për edicionin 2025/26, si dhe në ndeshjet e **ENBL** dhe të **Superligës së Meshkujve (Procredit Superliga)**, pa marrë pagesat përkatëse.
- (d) Klubi **KB Sigal Prishtina** nuk i ka kryer obligimet financiare ndaj lojtarit për sezonin e kaluar, si dhe për këtë sezon nuk ka kontratë të formalizuar, megjithëse ekziston një draft-kontratë e pa nënshkruar.
- (e) Komisioni i Garave i është drejtuar **KB Sigal Prishtina** me kërkesë për sqarim lidhur me pretendimet e lojtarit, por klubi nuk ka kthyer asnjë përgjigje.
- (f) Për mosrealizimin e obligimeve financiare nga ana e klubit, lojtari udhëzohet që, në përputhje me dispozitat e **kontratës për sezonin 2024/2025** dhe **draft-kontratës për sezonin 2025/2026**, të ndjekë rrugët ligjore përmes **Gjykatës Themelore në Prishtinë**.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.